



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 980 Date 14.12 2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
" UJESJELLES - KANALIZIME" PUKE SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise "Ujesjelles - Kanalizime" Puke, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 11.3 % nga Komuna Rrape, 8.8 % nga Komuna Qafe Mali, 20.7 % nga Komuna Gjegjan, 10.4 % nga Komuna Blerim, 11.3 % nga Komuna Qelez, 10.9 % nga Komuna Fierze, 15 % nga Komuna Qerret dhe 11.6 % nga Komuna Iballe, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore".

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENC RULI

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: smalko@mete.gov.al
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 228467
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

SHA "UJESJELLES KANALIZIME PUKE"
PUKE

119-1739/2016

NIPT: J69310307F

VENDIM

NR.01 DATE 28.09.2016

I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE AKSIONEREVE

Ne Puke, sot me date 28.09.2016, ne, Gjon Gjonaj – Kryetar i Bashkise Puke dhe Fran Tuci – Kryetar i Bashkise Fushe Arrez, perfaqesues te aksionereve, Bashkia Puke dhe Bashkia Fushe Arrez te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke", themeluar me date 01.07.1996, ne baze te kompetencat te parashikuara ne nenin 64/a/f te Ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", per shkak te ndarjes se re administrativo-territoriale sipas Ligjit Nr.115/2014, prej se ciles Bashkia Puke ka ne perberje edhe njesite administrative te krijuara nga ish komunat: Rrape, Qerret, Qelez dhe Gjegjan, ndersa Bashkia Fushe Arrez ka ne perberje edhe njesite administrative te krijuara nga ish komunat: Iballes, Blerim, Fierze dhe Qafe Mali, dhe ne zbatim te VKM Nr.63 date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", per riorganizimin e sha "Ujesjelles Kanalizime Puke" dhe,

V E N D O S E M :

1. Miratimin e statutit te riorganizimit dhe funksionimit te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke" sipas pikes 1, Kreu I dhe Kreu II i VKM Nr.63 date 27.01.2016, e drejte asamblese se aksionereve e percaktuar ne piken 2/b/h/j te nenit 135 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008.
2. Perberja e aksioneve me te drejte vote, vlera nominale per aksion dhe perqindja e pjesemarrjes ndryshon sipas percaktimit ne nenin 4 te statutit te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke", miratuar ne piken 1 te ketij vendimi,
 - Kapitali perbehet nga nje kuote: 137.799.000 leke;
 - Vlera e kapitalit te shlyer: 137.799.000 leke;
 - Vlera nominale per aksion: 1.000 leke;
 - Numri i aksioneve me te drejte vote : 137.799, te ndara:
 - a) **Bashkia Puke**, numri i aksioneve me te drejte vote 80336.80, perqindja e pjesemarrjes 58,30.
 - b) **Bashkia Fushe Arrez**, numri i aksioneve me te drejte vote 57462.20, perqindja e pjesemarrjes 41,70.
3. Shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke", ne baze te pikes 2/c te nenit 135 dhe pikes 4 te nenit 167 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008,
 - Pal Mbrozi
 - Flora Palushi
 - Tonin Prenga
4. Revokimin e administratorit, z. Ndue Pali, dhe emerimin e administratores te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke", zj. Drita DINI me karte ID numer personal G25722015M dhe Mobil: 0672070301, **per 3 muaj**, ne baze te nenit 135/2c dhe 157/1 te Ligjit Nr.9901.
5. Emerimin e anetareve te Keshillit te Administratimit, ne baze te nenit 135/2c dhe 158/1 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, per 3 muaj.
 - Drita DINI
 - Pashk GJETAJ
 - Ismet AHMETAJ
6. Vendim hyn ne fuqi menjehere dhe depozitohet ne QKB, nga administrator, Drita DINI.

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E AKSIONEREVE TE SHA "UJESJELLES KANALIZIME PUKE"

BASHKIA FUSHE ARREZ

KRYETARI

Fran TUCI

BASHKIA PUKE

KRYETARI

Gjon GJONAJ

SHA "UJESJELLES KANALIZIME PUKE"
PUKE

NIPT: J69310307F

VENDIM

NR.04 DATE 30.06.2017

I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE AKSIONEREVE

Ne Puke, sot me date 30.06.2017, ne, Gjon Gjonaj – Kryetar i Bashkise Puke dhe Fran Tuci – Kryetar i Bashkise Fushe Arrez, perfaqesues te aksionereve, Bashkia Puke dhe Bashkia Fushe Arrez te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke", themeluar me date 01.07.1996, ne baze te kompetencat te parashikuara ne nenin 64/a/f te Ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne zbatim te pikes 1 te Kreu I, te pikes 2 te Kreu II, e vijues te VKM Nr.63 date 27.01.2016 "Per riorganizmin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", per riorganizmin e sha "Ujesjelles Kanalizime Puke",

V E N D O S E M :

1. Miratimin e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar te zonjes Shpresa Ismaili date 30.06.2017 "Per zvogelimin dhe transferimin e aksioneve te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke";
2. Zvogelimin e Kapitali Aksionar te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke" per 3.098.000 leke, e barabarte me 3.098 aksione me te drejte vote te zoteruara nga Aksionari Bashkia Fushe - Arrez, me vlere nominale 1000 leke per aksion, qe perfaqesojne vleren reale te kapitalit qe transferohet tek sha "Ujesjelles Kanalizime Fushe - Arrez".
3. Pjesemarrja e mbetur e Aksionarit Bashkia Fushe - Arrez ne kapitalin aksionar te sha "Ujesjelles Kanalizime Puke" per 54364,20 aksione me te drejte vote, e barabarte me 54.364.200 leke, transferohet pa pagese tek Aksionari Bashkia Puke.
4. Kapitali Aksionar i sha "Ujesjelles Kanalizime Puke" pas zvogelimit dhe transferimit te aksioneve te zoteruara nga Aksionari Bashkia Fushe - Arrez, eshte 134.701.000 leke, i barabarte me 134.701 aksione me te drejte vote, me vlere nominale 1000 leke per aksion, aksione te cilat zoterohen 100 % nga Aksionari i Vetem, Bashkia Puke.
5. Vendim hyn ne fuqi menjehere dhe depozitohet ne QKB, nga administratori, Petrit DEDAJ.

ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E AKSIONEREVE TE SHA "UJESJELLES KANALIZIME PUKE"

BASHKIA FUSHE ARREZ

KRYETARI

Fran TUCI



BASHKIA PUKE

KRYETARI

Gjon GJONAJ

